



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

C-III-19-0138

Xh B, T B, F B dhe Sh B, R B1, R B2, H B. adresa: Fshati S, Komuna e Prishtinës

*Paditësi*

Kundër:

KBI "Kosova Export", me seli në Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, adresa: Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Komuna e Prishtinës

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), kolegji në përbërje nga gjyqtari Bajram Miftari – kryesues i kolegjit dhe Gazmend Sylaj e Sylejman Shumolli - anëtarë të kolegjit, me datën 14.06.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje kontestimore, pas njoftimit të gjykatës se paditësja R B ka vdekur.

**II.** Procedura e ndërprerë mund të vazhdohet në çdo kohë, nëse pasardhësit e paditëses e zhvillojnë paraprakisht procedurën trashëgimore dhe gjykatës i dorëzojnë aktin e trashëgimisë, bashkë me propozimin për vazhdimin e procedurës.

#### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datën 03.02.2010, paditësit Xh B; R B1; R B2, H B kanë paraqitur padi pran Dhomes së Posaçme, me të cilën ka propozuar rishikimin e vendimit të AKP-së - Autoritetit të Likuidimit, PRZ-009-0093, të datës 29.06.2015.

Më 14.06.2023 gjykata ka mbajtur seancë dëgjimore me palët në procedurë, në të cilën seancë, paditësi R B1 ka deklaruar se paditësja R B2 ka vdekur. Në seancë nuk është paraqitur askush nga pasardhësit / trashëgimtarët e saj, ku do të mund të trajtohej çështja e trashëgimisë dhe e legjitimitetit aktiv procedural.

## **Arsyetimi ligjor**

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Me nenin 278. paragrafi 1, pika a) të LPK-së, është e përcaktuar se procedura kontestimore ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Bajram Miftari, Gjyqtar Kryesues

Gazmend Sylaj, Gjyqtar

Sylejman Shumolli, Gjyqtar